Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit**
Programi:	**Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobilieve**
Titulli i lëndës:	**Mobiliet e Buta**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**II**
Numri i orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**5**
Mësimëdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	Lënda trajton njohuritë rreth projektimit, konstruksionit dhe prodhimit të mobilieve të buta. Analizon respektimin e përmasave antropometrike dhe ergonomike të tyre sipas standardeve. Procesin teknologjik të realizimit të tyre, përfshirë lëndët e para e ndihmëse. Mënyrën e realizimit të konstruksioneve të mobilieve të veshura me materiale të tapicerisë. Qëndrueshmërinë e konstruksioneve dhe materialeve amortizuese; përfshirë sustat, rripat e tapicerisë, etj. Vetitë teknike, estetike, ergonomike dhe higjenike të materialeve mbushëse dhe veshëse të mobilieve të buta. Aspekte estetike, funksionale dhe të jetëgjatësisë të detajeve; përfshirë mënyrën e realizimit të tegelave, qëndisjeve dhe aksesorëve të shumëllojshëm që përdoren në veshjen e mobilieve me tapiceri.
Qëllimet e lëndës:	Lënda synon përgatitjen e studentëve me njohuritë e nevojshme për projektimin dhe prodhimin e mobilieve të buta. Fokusohet në realizimin e konstruksionit të tyre përfshirë përdorimin e materialet e ndryshme për realizimin e skeletit. Materialet mbushëse dhe veshëse të tapicerisë. Karakteristikat dhe vend-përdorimin e tyre. Cilësitë e tyre fiziko-mekanike, ergonomike, estetike, përfshirë aspektin ekonomik dhe ekologjik. Përdorimin

	e tyre për prodhimin e mobilieve.
Rezultatet e pritura të nxënies:	*Në përfundim të lëndës studenti duhet të njohë:* • *Projektimin e mobilieve të buta bazuar në përmasat antropometrike dhe ergonomike të tyre sipas standardeve;* • *Procesin teknologjik të prodhimit të mobilieve të buta, përfshirë lëndët e para e ndihmëse;* • *Mënyrën e realizimit të konstruksioneve të mobilieve të veshura me materiale të tapicerisë;* • *Qëndrueshmërinë e konstruksioneve dhe materialeve amortizuese; përfshirë sustat dhe rripat e tapicerisë;* • *Vetitë teknike, estetike, ergonomike dhe higjenike të materialeve mbushëse dhe veshëse të mobilieve të buta;* • *Detajet që përdoren në veshjen e mobilieve të buta përfshirë: anën estetike, funksionale dhe të jetëgjatësisë;* • *Mënyrën e realizimit profesional të tyre.*

Kontributi në ngarkesën e studentit që korrespondon me rezultatet e të nxënit të studentit (duhet të korrespondojë me numrin e krediteve. d.m.th. 1 kredit = 25 orë).			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithsej**
Ligjërata	2	14	28
Ushtrime teorike/laboratorike	1	14	14
Punë praktike	3	1	3
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	9	9
Ushtrime në teren	3	1	3
Kollokfiume, seminare	0	0	0
Detyra të shtëpisë	2	8	16
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1

Totali			**126**
Metodologjia e mësimëdhënies:	*Ligjërata dhe ushtrime të kombinuara me raste studimi*		
Metoda e vlerësimit:	Punim seminarik (Projekt Kursi) 30% Provimi përfundimtar 70% *Provimi mbahet me pyetje të hapura.*		
Literatura			
Literatura bazë:	1. *Diomoshi S, Konica A, Materiale ndihmëse në industrinë e drurit (1998)* 2. *Upholestry, a Complete Course Chairs, Sofas, Ottomans, Screens, and Stools: David James* 3. *K. Ganesh • Sanjay Mohapatra S. Nagarajan Design and Development of Knowledge Management for Manufacturin* 4. *Spruce A Step-by-Step Guide to Upholstery and Design: Amanda Brown, Grace Bonneyg*		
Literatura shtesë:	5. *Talka Q, Menaxhimi i prodhimit dhe operacioneve (2008)* 6. *Gëdeshi L, Menaxhimi i prodhimit (2014)* 7. *Smart Materials in Architecture, Interior Architecture and Design, Riter, A.*		

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	**Ligjërata që do të zhvillohet**
Java e parë:	**Hyrje: koncepte të përgjithshme për mobiliet e buta**
Java e dytë:	**Projektimi i mobileve të buta**
Java e tretë:	**Antropometria dhe standardet e mobilieve të buta**
Java e katërt:	**Organizimi planimetrik i mobilieve të buta**
Java e pestë:	**Procesi teknologjik i prodhimit të mobilieve të buta**
Java e gjashtë:	**Procesi teknologjik i prodhimit të mobilieve të buta**
Java e shtatë:	**Konstruksionet e mobilieve, konstruksionet nga druri masiv**
Java e tetë:	**Konstruksionet nga metalet, plastika dhe kombinime të ndryshme**
Java e nëntë:	**Skeletet e tapicerisë dhe realizimi i tyre**
Java e dhjetë:	**Materialet mbushëse të mobilieve të buta**
Java e njëmbedhjetë:	**Materialet veshëse të mobilieve të buta**
Java e dymbëdhjetë:	**Njohja me teknologjinë e prodhimit në praktikë**
Java e trembëdhjetë:	**Vlerat arkitektonike të tapicerisë në projektimin e interierit**

Java e katërmbëdhjetë:	**Aspektet estetike: aksesorët, dekoret, tegelat, etj.**
Java e pesëmbëdhjetë:	**Aspekte ergonomike, ekologjike dhe të shëndetit të njeriut**
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.	